



VENDIM

Nr. 117, Datë 15.07.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT
PËR ÇERTIFIKIMIN NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT
TË TRANSMETIMIT” SH.A.**

Në mbështetje të nëneneve 3 pika 8; neni 16; neni 54 dhe 58 pika 1, 3, dhe 5, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, si dhe nëneneve 6, 7, 8, 9 pika 1, neni 10 dhe 12 të “Rregullave për Çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit”, miratuar me vendimin nr. 154 datë 11.12.2015 të Bordit të ERE-s, neni 19 pika 1 gërma “b” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin Bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 15.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike, mbi aplikimin e OST Sh.a., për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike,

Duke konsideruar që:

- Shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., me shkresën Nr. 4179 prot, datë 13.07.2016, rregjistruar në ERE me Nr. 545 prot, datë 13.07.2016, ka paraqitur kërkesën, për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST-E),
- Kjo kërkesë për miratim, mbështetet në sa përcaktuar në nenin 54 dhe 58 të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe “Rregullave për Çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 154, datë 11.12.2015, si dhe pikës 4 të VKM.Nr 317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Shoqërive të Sektorit të Energjisë Elektrike” e cila përcakton se: menjëherë

mbas hyrjes në fuqi të këtij vendimi OST-ja, aplikon në ERE për certifikim në bazë të nenit 58 të ligjit 43/2015;

- Për efekt të këtij aplikimi nga OST sh.a., bashkë me kërkesën me shkrim për certifikim janë depozituar dokumentat e parashikuara ne nenin 9 të “Rregullave për Çertifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s, nr. 154, datë 11.12.2015.
- Të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacioni I kërkuar sipas Nenit 9, të Rregullores janë paraqitur ne ERE në gjuhën Shqipe dhe atë Angleze me shkrim dhe në mënyrë elektronike.
- ERE ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar por mund të kërkojë nga Operatori I Sistemit të Transmetimit çdo informacion të nevojshëm për qëllim të certifikimit referuar pikës 4 të nenit 58 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- ERE në cilësinë e autoritetit përgjegjës për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe të detyrimeve sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë ratifikuar me Ligjin Nr.9501 datë 03.04.2006, ka miratuar me vendimin nr.154, datë 11.12.2015, “Rregullat për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike”.
- Neni 9 i vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, neni 58 pika 6 e ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon që ERE, duhet të vërë në dijeni Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e shprehur apo të pashprehur me fjalë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit për certifikimin në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike të OST Sh.a.
2. Ti përcjellë këtë vendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për opinion ashtu si përcaktohet në nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”,
3. Të përcjellë këtë vendim Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.